



Komisioni për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Familjeve Përfituese mbi Ndarjen e Banesave sipas Programeve të Veçanta të Banimit me Qira Joprofitabile

01 Nr. 360-1521/20
Datë: 13.01.2020

Në bazë të nenit 17, (shkronja I), Të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, paragrafi 1, pika 1.3, nenit 4, nenit 5, nenit 11 dhe 12 të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit, nr.03/L-164, dt. 25.02.2010, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 22/2010, për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, konkursit 360-43810/19, i dt. 22.11.2019, në bazë edhe të vendimit të Kryetarit të Komunës 01 Nr.112-45816, të datës 06.11.2019, për caktimin e komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve përfituese nga programi i veçantë i banimit, si dhe nenit 91, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës, nr. 01-110-1232/2010, Komisioni Komunal për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Familjeve Përfituese mbi Ndarjen e Banesave sipas Programeve të Veçanta të Banimit me Qira Joprofitabile, mori këtë:

V E N D I M

(Për shpalljen e listës së familjeve përfituese të renditura sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit)

I.

U Njihet e Drejta në Shfrytëzim të Përkohshëm me Qira Joprofitabile të (5) pesë njërive banesore në pronësi komunale, familjeve të përzgjedhura nga Komisioni të cilat kanë përfutuar nga ky program i veçantë i banimit social, si më poshtë:

Nr.	Emri dhe Mbiemri Familjet Përfituese nga Programi	Vendbanimi / Adresa	Nr. i pikëve/poenëve
1	Sokol (Sadri) Gashi	Klinë	40
2	Sokol (Murat) Gashi	Klinë	34
3	Isaj (Ethem) Gashi	Sverkë	30
4	Yll (Hysen) Ymeri	Klinë	15
5	Shehide (Selman) Krasniqi	Klinë	15

II.

Pas kalimit të afatit të ankesave, Komuna Klinës, lëshon vendimet përfundimtare për secilin përfutues dhe njëkohësisht, lidhë kontratë mbi të drejtën e shfrytëzimit të banesës me qira joprofitabile, ku do përcaktohen kushtet dhe kriteret, mbi të drejtat e shfrytëzimit në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 18/2010 të MMPH.

III.

Kundër vendimit të komisionit komunal palët e pakënaqura mund të parashetrojnë ankesë me shkrim në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, përmes këtij organi, pa taksë administrative.

IV.

Me vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUNM), palët përfituese dhe arkiva.

Komisioni:

Ilir Bacaj

Driton Berisha

Ali Gashi